



UDHËZIM PËR TRAJTIMIN, MENAXHIMIN DHE TJETËRSIMIN E SKRAPIT

Fushë Kosovë

2026

Përmbajtja

1. Qëllimi	3
2. Baza ligjore	3
3. Fusha e zbatimit	5
4. Përkufizimi	5
5. Identifikimi dhe evidentimi i skrapit	5
6. Komisioni për trajtimin e skrapit	6
7. Ruajtja dhe siguria e skrapit	6
8. Shitja dhe tjetërsimi i skrapit	7
9. Asgjësimi i skrapit	7
10.Mbikëqyrja dhe përgjegjësitë	7
11.Hyrja në fuqi	7

Në bazë të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i HK-Trainkos Sh.A., në mbledhjen nr.33, të mbajtur më 31.03.2026, miraton:

UDHËZIM PËR TRAJTIMIN, MENAXHIMIN DHE TJETËRSIMIN E SKRAPIT

Neni 1

Qëllimi

Udhëzimi rregullon mënyrën e identifikimit, klasifikimit, ruajtjes, menaxhimit, shitjes dhe asgjësimit të skrapit që krijohet nga veprimtaria e Ndërmarrjes Publike Trainkos Sh.A.

Qëllimi i këtij udhëzimi është:

- Mbrojtja e pasurisë publike të HK - Trainkos Sh.A.;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies;
- Respektimi i legjislacionit të Republikës së Kosovës për trajtimin e skrapit;
- Mbrojtja e mjedisit dhe
- Siguria në punë.

Neni 2

Baza ligjore

Udhëzimi nxirret në bazë të legjislacionit në fuqi:

1. Ligjit Nr. 04/L-060 për Menaxhimin e Mbeturinave;
2. Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;
3. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
4. Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe
5. Instruksione tjera Administrative dhe Akte Nënligjore (jashtë dhe brenda HK Trainkos Sh.A.)

1. Ligjit Nr. 04/L-060 për Menaxhimin e Mbeturinave

Ky ligj është akti kryesor ligjor për mbeturina në Republikën e Kosovës i cili përcakton:

- Kategorizimin e mbeturinave, përfshirë mbeturinat ferro metalike dhe jo-ferro metalike;
- Detyrimet për mbledhje, transport, trajtim, riciklim dhe përfundim të trajtimit të mbeturinave;
- Licencimin e operatorëve që trajtojnë mbeturina dhe skrap;
- Principet mjedisore si “parimi i ndotësit paguan”;
- Promovimi i riciklimit;

- Detyrimet për mbajtjen e evidencave dhe
- Raportimin e saktë të mbeturinave.

Pika kyçe për trajtimin e skrapit sipas këtij Ligji është se përveç menaxhimit të përgjithshëm të skrapit kërkon që materialet që mund të riciklohen (p.sh. skrapit metalik) duhet të trajtohet në mënyrë të sigurt, të ndarë në fraksione të tjera dhe të dërgohet për riciklim ose përpunim sipas kërkesave për mbrojtjen e mjedisit.

2. Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike

Ky Ligj rregullon:

- Formimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e ndërmarrjeve publike dhe
- Detyrat e tyre për ofrimin e shërbimeve publike, përfshirë shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe trajtimit të materialeve që këto ndërmarrje ofrojnë në territorin e komunave përkatëse.

3. Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;

Në rast se ndërmarrjet publike blejnë shërbime për pajisje në grumbullimin, transportin, trajtimin dhe shitjen e skrapit aplikohet ky ligj për procedurat e prokurimit transparent.

4. Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale

Ky ligj rregullon gjithashtu disa çështje që kanë të bëjnë me trajtimin e skrapit, kryesisht rregullon:

- I jep kompetenca komunave për menaxhimin e mbeturinave dhe shërbimeve komunale, përfshirë grumbullimin dhe trajtimin e skrapit/mbeturinave në nivel lokal dhe
- Parashikon se komunat krijojnë sistemet dhe planifikimin për mbeturinat dhe bashkëpunojnë me ndërmarrjet publike për zbatimin e këtyre shërbimeve.

5. Instruksione tjera Administrative dhe Akte Nënligjore (jashtë dhe brenda HK – Trainkos Sh.A.)

Aktet bazike për trajtimin e skrapit shoqërohen edhe me instruksione administrative të jashtme dhe të brendshme - HK Trainkos Sh.A., që mbështesin zbatimin e detyrimeve specifike të trajtimit të mbeturinave, të cilat ndikojnë në trajtimin e skrapit.

a) Instruksionet Administrative dhe Aktet e jashtme nënligjore (shembuj):

- Lista e kategorive të rrezikshme, përfshirë ato që kanë komponentë metalike potencialisht të dëmshme;
- Instruksione për mbeturina nga mjetet lëvizëse (tërheqëse dhe të tërhequra), automjetet dhe pajisjet elektrike të dala nga përdorimi, që ndërlidhen shpesh me skrap metalik dhe
- Ndonjë Instruksion Administrativ apo Akt Nënligjorë tjetër sipas specifikës.

- b) Instruksionet Administrative dhe Aktet e brendshme nënligjore:
- Statuti i Ndërmarrjes dhe
 - Rregullore tjera që mund të mbështesin trajtimin e skrapit të Ndërmarrjes.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet në të gjitha njësitë organizative të HK Trainkos Sh.A., përfshirë:
 - 1.1 Sektorët e transportit hekurudhor të udhëtarëve dhe mallrave (DOH);
 - 1.2 Mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse (tërheqëse dhe të tërhequra);
 - 1.3 Depot, punëtoritë dhe magazinat dhe
 - 1.4 Administratën e Përgjithshme.
2. Zbatimi është i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e ndërmarrjes.

Neni 4

Përkufizimi

1. **Skrap** – çdo material, pajisje ose pjesë e mjeteve lëvizëse që është jashtë funksionit, e amortizuar ose teknikisht e papërdorshme;
2. **Skrap hekurudhor** – pjesë lokomotivash, vagonësh, sisteme frenimi, motorë, komponentë elektrike, metalike dhe jo metalike;
3. **Komisioni për Skrap** – organ i përkohshëm i autorizuar për vlerësimin dhe trajtimin e skrapit dhe
4. **Tjetërsim** – shitja ose asgjësimi i skrapit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Identifikimi dhe evidentimi i skrapit

1. Çdo njësi organizative e HK Trainkos Sh.A., është e obliguar të identifikojë pajisjet dhe materialet që nuk janë më funksionale përmes proceseve tanimë të zbatueshme në Ndërmarrje;
2. Për çdo rast specifik sipas përgjegjësive përpilohet procesverbal i cili përmban:
 - 2.1 Përshkrimin teknik të skrapit;
 - 2.2 Sasinë, llojin, peshën dhe vlerën;
 - 2.3 Numrin e regjistrimit të secilës njësi sipas evidencave standarde të aplikueshme në HK Trainkos Sh.A. dhe
 - 2.4 Arsyen e nxjerrjes jashtë përdorimit.
3. Skrapi regjistrohet në evidencën e pasurive të Trainkos-it.

Neni 6

Komisioni për Trajtimin e Skrapit

1. Kryeshefi Ekzekutiv i HK Trainkos Sh.A., me vendim të posaçëm, themelon Komisionin për Trajtimin e Skrapit;
2. Komisioni përbëhet nga së paku pesë (5) anëtarë:
 - Një përfaqësues nga sektori teknik;
 - Një përfaqësues nga financat;
 - Një përfaqësues nga depot/logjistika;
 - Një përfaqësues nga sektori juridik dhe
 - Një përfaqësues nga kontrolli i brendshëm.
3. Komisioni ka përgjegjësi për:
 - 3.1 Vlerësimin teknik dhe ekonomik të skrapit;
 - 3.2 Propozimin për ripërdorim, shitje ose asgjësim dhe
 - 3.3 Përgatitjen e raportit për menaxhmentin dhe bordin, varësisht sipas kategorisë së skrapit.

Neni 7

Ruajtja dhe siguria e skrapit

1. Skrapi ruhet në hapësira të dedikuara dhe të sigurta të HK Trainkos Sh.A., paraprakisht të përcaktuara sipas llojit dhe kategorisë së skrapit;
2. Ndalohet rreptësisht largimi, shitja ose dhurimi i skrapit pa vendim zyrtar, procedura të përcaktuara me akte normative dhe
3. Njësitë përgjegjëse brenda HK Trainkos Sh.A., sigurojnë:
 - 3.1 Mbrojtjen nga vjedhja dhe keqpërdorimi dhe
 - 3.2 Respektimin e masave të sigurisë dhe mjedisit.

Neni 8

Shitja dhe tjetërsimi i skrapit

1. Shitja e skrapit realizohet në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, procedura zhvillohen përmes:
 - 1.1 Ankandit publik ose
 - 1.2 Procedurës së hapur konkurruese.
2. Të ardhurat nga shitja e skrapit derdhen në llogaritë zyrtare të HK Trainkos Sh.A.

Neni 9

Asgjësimi i skrapit

1. Skrapi që nuk mund të shitet ose ripërdoret asgjësohet në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave;
2. Asgjësimi kryhet vetëm nga operatorë të licencuar në Republikën e Kosovës dhe
3. Për çdo proces asgjësimi përpilohet dokumentacion zyrtar.

Neni 10

Mbikëqyrja dhe përgjegjësia


1. Zbatimi i këtij udhëzimi mbikëqyret nga mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm të HK Trainkos Sh.A. dhe
2. Shkeljet e këtij udhëzimi dhe bazës legislative të precizuar në udhëzim përbëjnë shkelje disiplinore.


Neni 11

Hyrja në fuqi

1. Ky Udhëzim hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve të HK Trainkos Sh.A., dhe
2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohen të gjitha aktet e mëparshme që rregullojnë trajtimin e skrapit.

JETMIR NUKA



**Kryesues i Bordit të Drejtorëve HK-Trainkos-SH.A.**